

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR:
“AL Consult” SHPK**

Sot, me date 17.04.2024, ne te nenshkruarit:

1. Lidmir Hyseni, i biri i Demir dhe Lindita, i datelindjes 15.11.1998, lindur dhe banues ne qytetin e Pukes, me ID: J81115041S, dhe
2. Aleks Duka, i biri i Shaqir dhe Bajame, i datelindjes 11.10.1993, lindur dhe banues ne qytetin e Pogradecit, me ID: J31011026Q

me vullnet te lire dhe te plote perpilojme kete Akt Themelimi.

Neni 1

Krijohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “AL Consult”.

Neni 2

Shoqeria deklarohet e krijuar nen ruajtjen e plote te normave qe permban ky akt.

Neni 3

Veprimtaria e shoqerise, marredheniet e saj me personat e trete juridik e fizik, vendas e te huaj, shtetëror e privat, rregullohen ne baze te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 si dhe te akteve te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te ketij ligji. Shoqeria pergjigjet vetem per pasurine e saj.

Neni 4

Selia e shoqerise do te jete ne adresën: Rruga “Halil Terbuni” Blloku Nr.1, Banesa 148, Numer Pasurie 1/627, Zona Kadastrale 3069, Qyteti Puke, Bashkia Puke, Rrethi Puke, Qarku Shkoder, si dhe per komunikime elektronike do te sherbej adresa e email-it: alconsultshpk@gmail.com dhe mobil: +355674427788

Neni 5

Veprimtaria e shoqerise, emertimi dhe selia e saj te percaktuara ne kete Akt-Themelimi nuk mund te ndryshojne pa pelqimin e themeluesve te saj.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- 1) Mbikqyrje dhe kolaudim punime ndertimi;
- 2) Rilevime topografike, punime topogjeodezike;
- 3) Projektme te fushes se ndertimit;
- 4) Projektme e ndertime civile, industrial, turistike dhe bujqesore;
- 5) Projektim peisazhi dhe sistemimi;

- 6) Studime urbanistike te te gjitha niveleve;
- 7) Menaxhim dhe koordinim i projekteve te ndryshme;
- 8) Vleresim i pasurive te paluajtshme;
- 9) Prodhim energjie elektrike nga burime te rinovueshme;
- 10) Auditim energjie;
- 11) Tregti artikuj te ndryshem;
- 12) Import eksport;
- 13) Dhenje me qera te te gjitha llojeve.

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke e ndare ne dy kuota, me vlere nominale eshte 50.000 leke, te zoteruara nga, ortaket themelues:

1. Lidmir Hyseni, zoteron nje kuote kapitali ne para, me vlere nominale 50.000 leke, e barabarte me 50 % te kapitalit te pergjithshem te shoqerise.
2. Aleks Duka, zoteron nje kuote kapitali ne para, me vlere nominale 50.000 leke, e barabarte me 50 % te kapitalit te pergjithshem te shoqerise.

Neni 8

Per nevoja te punes dhe te ushtrimit te aktivitetit te tyre shoqeria mund te çele llogari ne çdo banke te njohur me ligj, qofte kjo private apo shtetore.

Neni 9

Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise do te jete mbi 10 vjet. Por ajo mund te ndryshojë afatin e ushtrimit të aktivitetit me vendim te asamblese se ortakeve.

Gjithashtu shoqeria mund te shperndahet edhe perpara ketij afati per rastet e parashikuara me ligj.

Neni 10

Shoqeria perbehet nga nje ortak i vetem. Administrator i shoqerise do te jete Lidmir Hyseni, i cili zgjidhet per nje afat 5 vjeçar me te drejte rizgjedhje, me numer karte identifikimi: J81115041S.

Neni 11

Ortaket mbajne pergjegjesi vete per ruajtjen e karakterit te fshehtesise se aktivitetit dhe te dokumentacionit te shoqerise.

Neni 12

Organet e shoqerise jane:

- 1- Vendimi i Asamblese se Ortakeve
- 2- Administrator i Shoqerise, Lidmir Hyseni

3- Komisioni i eksperteve kontabel

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre percaktohen ne statutin bashkengjitur.

Neni 13

Per nevoja te punes kjo shoqeri mund te punesoje edhe punetore e specialiste te ndryshem, me kontrata pune te rregullta pune sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 14

Dispozita me te hollesishme per shoqerine percaktohen ne statutin bashkengjitur.


Neni 15

Ky akt themelimi u redaktua ne dy kopje.

Administratori, Lidmir Hyseni do te kryej regjistrimin sipas procedurave ne QKB te kesaj shoqerie.

ORTAKET THEMELUES

Lidmir Demir Hyseni



Aleks Shaqir Duka

